PIPK-BFS

Vendndodhja: Rajonale

Numri i projektit: 52407

Sektori i biznesit: Teknologjia e informacionit dhe komunikimit

Lloji i njoftimit: Privat

Kategoria mjedisore: FW

Data e miratimit: 10 mars 2021

Statusi: **Koncept i rishikuar**

Data e përhapjes së dokumentit në gjuhën angleze: 2 shkurt 2021

Përshkrimi i projektit

BERZH ka për qëllim të investojë në shoqëri teknologjike në fazën e rritjes që mbështeten në kapital aksionar përmes një instrumenti borxhi për financim me një vlerë investimi deri në 10 milionë euro, në vendet ku vepron Banka, përmes Programit të saj të Investimit me Pjesëmarrje në Kapital – Hua për financimin e sipërmarrjes (PIPK-BFS), i cili do të jetë një instrument i ri i programit ekzistues të BERZH-it, PIPK, dhe do të jetë një fond i dedikuar me vlerë prej 120 milionë euro). Investimet do të kenë për objekt ndërmarrjet e vogla dhe të mesme inovative dhe me rritje të lartë që kanë të provuar modelet e biznesit dhe kanë dëshmuar rritje të të ardhurave.

Prezantimi i instrumentit të huasë për financimin e sipërmarrjes zgjeron ofertën e produktit të BERZH-it për sipërmarrjet përtej kapitalit dhe do të kontribuojë në trajtimin e hendekut të tregut për mjete për financimin e sipërmarrjes në fazën e rritjes, në rajonet e BERZH-it.

Objektivat e projektit

Objektivat e PIPK-BFS janë: i) të mbështesë rritjen e bizneseve inovative të bazuara në teknologji dhe ii) të zhvillojnë tregun e huasë për financimin e sipërmarrjeve në rajonet ku qasja në financimin për kapital në fazën e rritjes është e kufizuar dhe huaja e sipërmarrjes më së shumti nuk është e disponueshme.

PIPK-BFS do të jetë një instrument shtesë i programit të gjerë PIPK, i cili i) i jep mundësi Bankës të promovojë ekonomitë e bazuara në njohuri, të zhvillojë eko-sisteme të teknologjisë dhe të mbështesë inovacionin; ii) përmes PIPK-së, Banka luan një rol të rëndësishëm në tejkalimin e hendekut për financimin e riskut të sipërmarrjes; iii) PIPK i jep mundësi Bankës që të mbajë një portofol për mundësi investimi me risk të lartë/kthim më të lartë investimit.

Ndikimi i tranzicionit

Pikët NPT (ndikimi i pritshëm i tranzicionit: 80)

Kuadri PIPK-BFS pritet të kontribuojë në cilësitë konkurrues dhe ripërtëritëse të tranzicionit pasi do të mbështesë rritjen e shoqërive inovative të bazuara në teknologji, si dhe do të promovojë një qasje më të mirë në hua për financimin e riskut të sipërmarrjes, i cili nuk ekziston në rajonet e BERZH-it. Duke u mbështetur në suksesin e PIPK I & PIPK II, PIPK-BFS do të lehtësojë dhe ofrojë mbështetjen kryesore për zhvillimin e ekonomisë së bazuar në njohuri në rajonet e BERZH-it, në përputhje me nismën e BERZH-it për ekonominë e bazuar në njohuri.

Informacion në lidhje me klientin

Rast pas rasti.

Përmbledhja e financave të BERZH-it

100.000.000 euro

Kosto totale e projektit

120.000.000 euro

Fonde shtesë

Përmes PIPK-BFS, BERZH do të ofrojë një instrument financues inovativ, për financimin e riskut të sipërmarrjes, me kushte tregtare, jo të disponueshme nga bankat e tjera ose fondet e dedikuara për mbulimin e riskut të sipërmarrjes në rajonet ku operon BERZH.

Përmbledhje mjedisore dhe sociale

Ky kuadër në vetvete nuk kategorizohet sipas politikës mjedisore dhe sociale (2019) të Bankës, megjithatë, secili nën-projekt do të kategorizohet rast pas rasti dhe do t'i nënshtrohet kontrollit individual mjedisor dhe social (KMS), si dhe projekti dhe klienti do t'i nënshtrohen ekzaminimit specifik TEGJ (tranzicioni në ekonominë e gjelbër). Në varësi të kategorisë së nën-projektit, KMS-ja e përshtatshme do të verifikojë nëse secili nën-projekt është i strukturuar në përputhje kërkesat e performancës (KP) së Bankës.

Bashkëpunimi teknik dhe financimi i granteve

Asnjë

Informacioni i kontaktit për shoqërinë

Bakhrom Ibragimov
02073386000

Përditësimi i fundit i DPS-së

5 shkurt 2021

Kuptimi i tranzicionit

Informacione të mëtejshme në lidhje me qasjen e BERZH-it për të matur ndikimin në tranzicion mund të gjenden këtu.

Mundësitë e biznesit

Për mundësi biznesi ose prokurimi, kontaktoni shoqërinë kliente.

Për mundësi biznesi me BERZH-in (që nuk kanë lidhje me prokurimin) kontaktoni:

Tel: +44 20 7338 7168
Email: projectenquiries@ebrd.com

Për projektet e sektorit shtetëror, vizitoni faqen e Prokurimeve të BERZH:
Tel: +44 20 7338 6794
Email: procurement@ebrd.com

Kërkesa të përgjithshme

Kërkesa të veçanta mund të dërgohen me anë të formularit të BERZH për dërgimin e pyetjeve.

Politika mjedisore dhe sociale (PMS)

PMS dhe kërkesat e performancës (KP) të lidhura me të përcaktojnë si BERZH-i duhet të zbatojë angazhimin e vet për të promovuar "zhvillimin e qëndrueshëm mjedisor". Si PMS-ja ashtu edhe KP-të përfshijnë dispozita specifike që klientët të jenë në përputhje

me kërkesat e zbatueshme të legjislacionit kombëtar për informimin dhe konsultimin e publikut, si dhe për të krijuar një mekanizëm për marrjen e ankesave, i cili synon të presë dhe lehtësojë zgjidhjen e shqetësimeve dhe ankesave të palëve të interesit, në veçanti, në lidhje me performancën mjedisore dhe sociale të klientit dhe projektit. Në përpjesëtim me natyrën dhe shkallën e rreziqeve dhe ndikimeve mjedisore dhe sociale të një projekti, BERZH-i do t'iu kërkojë klientëve të saj të bëjnë publik informacion, sipas rastit, rreth rreziqeve dhe ndikimeve që lindin nga projektet ose të kryejnë konsultime domethënëse me palët e interesit, si dhe të marrin në konsideratë dhe t'iu përgjigjen komenteve të dhëna prej tyre.

PMS paraqet më shumë informacion mbi praktikat e BERZH-it në këtë drejtim.

Integriteti dhe pajtueshmëria

Zyra e Shefit të Pajtueshmërisë (OCCO) të BERZH-it promovon qeverisjen e mirë dhe siguron që standardet më të larta të integritetit të zbatohen në të gjitha aktivitetet e Bankës në përputhje me praktikat më të mira ndërkombëtare. Të gjithë klientët e Bankës i nënshtrohen kontrollit të integritetit për të siguruar që projektet të mos paraqesin integritet të papranueshëm ose risk për reputacionin e Bankës. Banka beson se identifikimi dhe zgjidhja e çështjeve në fazat e miratimit e vlerësimit të projektit është mjeti më i efektshëm për të siguruar integritetin e transaksioneve të Bankës. OCCO luan një rol kyç në këto përpjekje mbrojtëse dhe, gjithashtu, ndihmon në monitorimin e rreziqeve ndaj integritetit të projekteve pas investimit.

OCCO është gjithashtu përgjegjëse për hetimin e pretendimeve për mashtrim, korrupsion dhe shpërdorim të detyrës në projektet e financuara nga BERZH-i. Kushdo qoftë, brenda ose jashtë Bankës , që ka dyshime për mashtrim ose korrupsion duhet të dërgojë një raport me shkrim drejtuar Shefit të Pajtueshmërisë me postë elektronike në compliance@ebrd.com. Të gjitha çështjet e raportuara do të trajtohen dhe ndiqen nga OCCO. Të gjitha raportet, përfshirë ato anonime, do të rishikohen. Raportet mund të bëhen në çdo gjuhë të Bankës ose të vendeve ku operon Banka. Informacioni i dhënë duhet të jetë në mirëbesim.

Politika e qasjes në informacion (PQI)

PQI përcakton mënyrën si BERZH përhap informacion dhe këshillohet me palët e interesit në mënyrë që të promovojë ndërgjegjësimin dhe kuptimin më të mirë të strategjive, politikave dhe operacioneve të saj, pas hyrjes në fuqi më 1 janar 2020. Lutemi të vizitoni faqen e politikës për qasjen në informacion për të parë se çfarë informacioni është në dispozicion në faqen e internetit të BERZH-it.

Kërkesa të veçanta për informacion mund të dërgohen me anë të formularit të BERZH-it për dërgimin e pyetjeve.

Mekanizmi për dhënien e llogarisë në mënyrë të pavarur nga projekti (MLLPP)

Nëse përpjekjet për të trajtuar problemet mjedisor, social ose përhapjes së informacionit me Klientin ose Bankën janë të pasuksesshme (p.sh. përmes mekanizmit të ankesave të projektit të Klientit ose përmes angazhimit të drejtpërdrejtë të Bankës), individët dhe organizatat mund të kërkojnë që shqetësimet e tyre të zgjidhen përmes mekanizmi të BERZH-it për dhënien e llogarisë në mënyrë të pavarur nga projekti (MLLPP).

MLLPP rishikon në mënyrë të pavarur problemet e Projektit që besohet të kenë shkaktuar (ose mund të shkaktojnë) dëm. Qëllimi i mekanizmit është: të mbështesë dialogun mes palëve të interesit të Projektit për të zgjidhur çështjet mjedisore, sociale dhe të përhapjes së informacioni; të përcaktojë nëse Banka ka vepruar në përputhje me politikën e saj mjedisore dhe sociale ose dispozitat specifike të politikës së Projektit për qasjen në informacion; si dhe, nëse është e zbatueshme, për të trajtuar çdo papajtueshmëri ekzistuese me këto politika, duke parandaluar çdo papajtueshmëri të ardhshme nga ana e Bankës.

Lutemi të vizitoni faqen në internet të mekanizmit për llogaridhënien e pavarur nga projekti për të parë mënyrën e paraqitjes së një kërkese për shqyrtim përmes formularit konfidencial online, duke e dërguar me atë të postës elektronike, postë ose telefon. MLLPP është në dispozicion për të diskutuar shqetësimet tuaja dhe për t'iu përgjigjur çdo pyetje që mund të keni në lidhje me paraqitjen ose trajtimin e kërkesave, të cilat ndjekin politikën e llogaridhënies së projektit dhe udhëzimet. Identiteti i kërkuesit mund të mbahen sekret, sipas kërkesës.